



Duke u mbështetur në nenin 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 dhe nenit 15 pika 15.1.2.3 dhe 15.4 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, Nr.04/L-174, Vendimit për Dhënie të Pëlqimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës, Nr.14/3306/1-ZSP/120/14 të dt 30.06.2014, Vendimit për dhënie të Pëlqimit në Planin Zhvillimor Komunal 2014-2021 të Klinës, Nr.5835-2/14 të dt. 05.01.2015 nga MMPH, kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të dt.04.12.2014, Raportit të Punës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës me theks të veçantë në shqyrtimin publik janar 2014 me 06, Nr.350-3251/2014 të dt.13.06.2014, Raportit të Debatit me Publikun të dt. 10.12.2012- shkurt 2013, me rekomandimet e KPF të dt.15.12.2014 dhe 08.06.2015, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VI-të të rregullt për vitin 2015 të mbajtur, më 19.06.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për

Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal –PZHK për periudhën 2014-2021

I

Miratohet Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Klinës 2014-2021.

II

Plani si në pikën një të këtij Vendimi është një plan strategjik multi-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjate të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor.

Plani përfshin: planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë se paku tetë (8) vjeçare.

III

Plani Zhvillimor Komunal përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik mbi të cilat bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës.

IV

Pjesë përbërëse e këtij Plani zhvillimor komunal është teksti i plotësimeve dhe ndryshimeve lidhur me ndërrimin e destinimit të dy ngastrave të poshtëshënuara dhe atë si në vijim i miratuar nga Kuvendi i Komunës në po këtë seancë, që:

1.Parcela kadastrale, Nr.279-0 në Këpuz, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1. 50, 83 ha, ndërsa kërkesa për ndërtim të objektit të Xhamisë është prej 0.10,00 ha, ZK në Këpuz , pronë shoqërore e Kuvendit Komunal Klinë, sipas certifikatës pronësore, Nr.11-665-2015 e dt.23.02.2015, e tretmanit deri

me tani tokë bujqësore, ku duhet të i ndërrohet destinimi dhe tani e tutje të bëhet tokë ndërtimore për qëllimin e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për ndërtim të objektit të Xhamisë, si dhe

2. Parcela kadastrale në Deiq, Nr.100-0 në sipërfaqe prej 2115 metra katror (0.21,15 ha) ZK -Deiq, e cila evidentohet sipas certifikatës së pronësisë, Nr.10-6636 të dt.17.03.2015, pronë shoqërore, e tretmanit deri me tani pronë shoqërore-rrugë, ku duhet t'i ndërrohet destinimi dhe tani e tutje të bëhet tokë ndërtimore, për qëllimin e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për ndërtim të objektit të Kishës Katolike.

V

Për ekzekutimin e këtij Vendimi kompetent është Kompania Urban Plus me seli në Prishtinë, e cila do të bëjë inkorporimin e plotësimeve dhe ndryshimeve në PZHK si nga pika 4 e këtij Vendimi si dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe MM.

VI

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb - faqen zyrtare të Komunës, kjo në kuptim të nenit 18 i Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 01/2013 dt.24.01.2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve Komunale.

VII

Me këtë Vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Drejtoria komunale e Urbanizmit dhe MM, MAPL, Kompanija Urban Plus në Prishtinë përmes Drejtorisë, një kopje për ueb-faqen e Komunës, një kopje mbetet në Shërbimin për Punë të Kuvendit dhe një për Arkivin e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 05-4097 /2015
Klinë, më 19.6.2015



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh nevojën për Planin Zhvillimor Komunal, sipas:

1. Kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit të vitit 2010 për Inicimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.
2. Vendimit të Kuvendit Komunal, 01Nr.350-1539/10 të dt.05.05.2010, për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.
3. Vendimit për Dhënie të Pëlqimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës, Nr.14/3306/1- ZSP/120/14 të dt 30.06.2014,
4. Vendimit për dhënie të Pëlqimit në Planin Zhvillimor Komunal 2014-2021 të Klinës, Nr.5835-2/14 të dt. 05.01.2015 nga MMPH,
5. Kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe MM për miratim të Vendimit për PZHK nga Kuvendi Komunal - 01, Nr.351-5298/14 të dt.04.12.2014,
6. Raportit të Debatit me Publikun të mbajtur me 10.12.2012 deri në shkurt 2013,
7. Preferencave dhe rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa të dt.15.12.2014 dhe 08.06.2015.

I gjithë ky proces procedural ka ardhur në përfundim me Vendimin për miratim të PZHK 2014-2021, të dt.19.06.2015 të miratuar nga KK-Klinë, duke vënë në miratim edhe tekstin si në pikën katër(4) të këtij vendimi, që obligon kompanin Urban Plus në Prishtinë, për vënie në PZHK- pas ridestinitimit të dy pronave shoqërore prej pronës shoqërore/bujqësore në tokë – ndërtimore në Këpuz për qellimin e dhenjës në shfrytëzim afatgjatë të pronës së palujtëshme komunale, për ndërtim të objektit të Xhamisë dhe pronës shoqërore/rrugë në tokë - ndërtimore në Deiq të Komunës së Klinës për qellimin e dhenjes në shfrytëzim afatgjatë të pronës së palujtëshme komunale për ndërtim të objektit Kishës Katolike.

Pasi që Plani Zhvillimor Komunal 2014-2021 kishte marrë pëlqimin nga MMPH-në Prishtinë dhe kërkesat nga Bashkesit fetare si më lartë kishin ardhur për miratim në Kuvendin e Komunës në muajin shkurt dhe mars 2015, me qëllimin për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të dy pronave shoqërore komunale me procedurë si raste të veçanta për ndërtim të dy objekteve fetare, Kuvendi i Komunës vendosi si në Vendimin e lartëcekur.

Bashkëngjitur Vendimit do të jenë të gjitha aktet paraprake të cilat kanë ardhur deri te finalizimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës të dt.19.06.2015.